



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

SHQYRTIMI I TARIFAVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE 2009 – PËRGJIGJE NDAJ KOMENTEVE

2 prill 2009

DEKLARATË

Këto përgjigje janë përgatitur nga ZRRE-ja vetëm për qëllime informative. Ky nuk është dokument vendosës dhe nuk duhet të konsiderohet se përfaqëson ndonjë vendim të ZRRE-së.

1 Hyrje

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZrRE) është në procesin e rishikimit të tarifave me pakicë të energjisë elektrike që do të aplikohen nga KEK sh.a dhe ngarkesat e Transmisionit që aplikohen nga KOSTT sh.a. Rishikimi përfshinë shqyrtimin e komenteve të pranuar lidhur me të hyrat e lejuara të propozuara, dhe marrjen e vendimit për tarifën dhe ngarkesat me të cilat mbulohen këto të hyra të lejuara, pas shqyrtimit të këtyre komenteve.

Në Raportin Konsultativ të publikuar më 3 mars 2009, ZrRE-ja ka paraqitur analizën e saj të aplikimit të tarifave të pranuar nga KEK-u dhe KOSTT-i si dhe propozimet preliminare për të Hyrat e Lejuara dhe tarifën e reja që do të hyjnë në fuqi nga data 1 prill 2009. Palët e interesuara janë ftuar që të paraqesin komentet me shkrim lidhur me analizat e ZrRE-së, propozimet preliminare dhe të gjitha çështjet tjera lidhur me to. Palët e interesuara që kanë paraqitur komente janë:

- Korporata Energjetike e Kosovës (KEK)
- Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Kosovës (KOSST)
- Ministria e Energjisë dhe Minierave (MEM)
- Organizata joqeveritare Fol '08

Ky Dokument përgjigjesh përmbledh komentet kryesore të pranuar dhe përgjigjet e ZrRE-së mbi to, para prezantimit të draft propozimeve përfundimtare të ZrRE-së mbi të hyrat e lejuara dhe tarifën e reja të rregulluara. Komentet paraqiten sipas palëve të interesuara. Përderisa të gjitha komentet janë shqyrtuar nga ana e ZrRE-së, vetëm ato që kanë ndikim të konsiderueshëm në propozimet e dhëna në Raportin Konsultativ janë paraqitur këtu për saktësi.

Në çdo rast jepet një përmbledhje e komentit me fontin *italics* dhe pasohet me përgjigjen e ZrRE-së.

Pas shqyrtimit të komenteve, ZrRE-ja vazhdon të mbështesë propozimin e dhënë në Raportin Konsultativ, që paraqet rritje të të hyrave të lejuara prej 2.5%. Tarifën me pakicë dhe ngarkesat e propozuara të transmisionit që rezultojnë janë paraqitur në faqet në vijim.

Tabela 1: Propozimi për tarifaf e rregulluara me pakicë

Grupi Tarifor	Niveli i tensionit të furnizimit	Elementet tarifore	Njësia	Koha gjatë ditës (a)	Ekzistuese		Propozuar	
					Sezona e lartë 1 tetor - 31 mars	Sezona e ulët 1 prill - 30 shtator	Sezona e lartë 1 tetor - 31 mars	Sezona e ulët 1 prill - 30 shtator
0	110kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		981.00		1,006.00	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		545.00	545.00	559.00	559.00
		Energjia aktive (P), prej të cilës:	€/kWh	Tarifa e lartë	6.33	1.87	6.49	1.92
			€/kWh	Tarifa e ulët	2.63	1.54	2.70	1.58
		Energjia reaktive (Q); c)	€/kVArh		0.00	0.00	0.00	0.00
1	35kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		130.00		133.00	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		567.00	567.00	581.00	581.00
		Energjia aktive (P), prej të cilës:	€/kWh	Tarifa e lartë	6.62	2.87	6.79	2.94
			€/kWh	Tarifa e ulët	3.50	2.59	3.59	2.65
		Energjia reaktive (Q); c)	€/kVArh		0.64	0.64	0.66	0.66
2	10kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		54.00		55.00	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		489.00	489.00	501.00	501.00
		Energjia aktive (P), prej të cilës:	€/kWh	Tarifa e lartë	7.42	3.31	7.61	3.39
			€/kWh	Tarifa e ulët	4.00	3.01	4.10	3.09
		Energjia reaktive (Q); c)	€/kVArh		0.64	0.64	0.66	0.66
3	0.4kV Kategoria I (konsumatorët e mëdhenj të energjisë reaktive)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		30.00		31.00	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		284.00	284.00	291.00	291.00
		Energjia aktive (P), prej të cilës:	€/kWh	Tarifa e lartë	8.24	4.58	8.45	4.69
			€/kWh	Tarifa e ulët	5.20	4.32	5.33	4.43
		Energjia reaktive (Q); c)	€/kVArh		0.64	0.64	0.66	0.66
4	0.4kV Kategoria II	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		34.00		35.00	
		Energjia Aktive (P)	€/kWh	Tarifa e vetme	10.16	6.57	10.41	6.73
		Energjia aktive (P), prej të cilës:	€/kWh	Tarifa e lartë	12.22	8.01	12.53	8.21
			€/kWh	Tarifa e ulët	6.11	4.00	6.26	4.10
5	0.4kV matësi 2- tarifor (2-vlerësh, shtëpiak)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		24.00		25.00	
		Energjia aktive (P), për konsum:	€/kWh	Tarifa e lartë	4.53	3.25	4.64	3.33
			€/kWh	Tarifa e ulët	2.27	1.62	2.33	1.66
		<200kWh/muaj (Blloku i parë) prej të cilit:	€/kWh	Tarifa e lartë	6.27	4.49	6.43	4.60
			€/kWh	Tarifa e ulët	3.14	2.25	3.22	2.31
		200-600 kWh/muaj (Blloku i dytë) prej të cilit:	€/kWh	Tarifa e lartë	9.10	6.52	9.33	6.68
			€/kWh	Tarifa e ulët	4.55	3.27	4.66	3.35
6	0.4kV matësi 1- tarifor (1-vlerësh, shtëpiak)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		24.00		25.00	
		Energjia aktive (P), për konsum:	€/kWh	Tarifa e vetme	4.04	2.89	4.14	2.96
			€/kWh	Tarifa e vetme	5.59	4.00	5.73	4.10
		>600 kWh/muaj (Blloku i tretë) prej të cilit:	€/kWh	Tarifa e vetme	8.11	5.81	8.31	5.96
7	0.4kV (shtëpiak pa matës)	Konsumi i vlerësuar <200kWh/month	€/konsumator/muaj		21.00		21.50	
		Konsumi i vlerësuar 200-500kWh/month	€/konsumator/muaj		38.00		38.92	
		Konsumi i vlerësuar >600kWh/month	€/konsumator/muaj		64.00		65.58	
8	Ndrëçimi publik	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		34.00		35.00	
		Energjia aktive (P), për konsum:	€/kWh	Tarifa e vetme	8.21	8.21	8.42	8.42

Tarifa e lartë aplikohet prej 07:00 - 22:00 e hënë - e shtunë gjatë sezonës së lartë dhe 08:00 - 23:00 e hënë - e shtunë gjatë sezonës së ulët
Konsumatorët e regjistruar si raste sociale ngarkohen me normë zero

Tabela 2: Propozimi për ngarkesat e transmisionit

Grupi Tarifor	Niveli i tensionit te lidhjes	Elementi Tarifor	Njësia	Ekzistuese	Propozuar
Gjenerimi	400kV / 220kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kW/vit	0.000	0.000
		Ngarkesa për operim të sistemit	€/MWh	0.853	1.067
		Ngarkesa për operim të tregut	€/MWh	0.013	0.020
Gjenerimi	110kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kW/vit	0.000	0.000
		Ngarkesa për operim të sistemit	€/MWh	0.853	1.067
		Ngarkesa për operim të tregut	€/MWh	0.013	0.020
Gjenerimi	Distribucion	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kW/vit	0.000	0.000
		Ngarkesa për operim të sistemit	€/MWh	0.289	0.328
		Ngarkesa për operim të tregut	€/MWh	0.013	0.020
Furnizimi	400kV / 220kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kW/vit	3.618	4.636
		Ngarkesa për operim të sistemit	€/MWh	0.853	1.067
		Ngarkesa për operim të tregut	€/MWh	0.013	0.020
Furnizimi	110kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kW/vit	7.878	10.094
		Ngarkesa për operim të sistemit	€/MWh	0.853	1.067
		Ngarkesa për operim të tregut	€/MWh	0.013	0.020

2 Komentet e KEK-ut

Komentet e KEK-ut janë dorëzuar me shkrim më 13 mars 2009 me komentet shtesë që janë prezantuar më 24 mars 2009. Në disa prej komenteve kërkohej sqarim i mëtejshëm për rregullimet e bëra nga ZRrE në aplikacionin e KEK-ut. Këto nuk përsëriten këtu. Më shumë detaje mbi këto rregullime i janë dërguar ndaras KEK-ut dhe mund të vihen në dispozicion të palëve tjera të interesuara sipas kërkesës.

- a) *Në qoftë se ZRrE korrighon në vitin 2009 ndryshimet në mes të shpenzimeve kapitale të realizuara dhe të lejuara në vitin 2008, atëherë i njëjti rregullim duhet të aplikohet për shpenzimet operative. KEK konsideron po ashtu që rregullimi nuk duhet të bëhet meqë të hyrat aktuale të inkasuara në vitin 2008 kanë qenë nën vlerën e lejuar nga ZRRE-ja, prandaj KEK nuk ka mbi-mbuluar në raport me të hyrat e lejuara.*

Qëllimi i ZRrE-së është që të ofrohen stimuj për të licencuarit që ata të realizojnë shpenzimet kapitale për të cilat janë lejuar të hyrat duke pasur parasysh nevojën urgjente për investim në sistemin energjetik kosovar. Aty ku këto shpenzime nuk realizohen, ZRrE-ja rikthen diferencën. ZRrE-ja nuk e aplikon të njëjtën qasje për shpenzimet operative, meqë dëshiron të sigurojë që të licencuarit të kenë stimuj të mjaftueshëm për të menaxhuar këto kosto në mënyrë efikase.

Qasja konsistente e ZRrE-së ka qenë që KEK-u nuk duhet të mbulojë kostot e humbjeve të inkasimit, duke pasur parasysh që kjo do të nënkuptonte që pagesit e mirë të mbulojnë pagesit e këqinj. Nëse KEK-u nuk arrin të mbledhë të gjitha të hyrat e lejuara të përcaktuara nga ZRrE-ja atëherë ky është rrezik i KEK-ut dhe jo i konsumatorëve.

- b) *Parashikimi i KEK-ut për çmimet e importit bazohet në çmimet aktuale të kontratës për janar - mars 2009 që dalin nga një proces konkurrues i tenderimit. Këto çmime aktuale duhet të përdoren dhe jo çmimet e bazuara në vitet e mëparshme.*

ZRrE e sheh të arsyeshme që të krahasohen çmimet e importit kundrejt indekseve të jashtme të çmimit për të vlerësuar arsyeshmërinë e tyre. ZRrE po ashtu vëren se çmimet e importit pritet të zvogëlohen në 2009 krahasuar me 2008 për shkak të rënies të çmimit të karburantit dhe kushteve rajonale të tregut, dhe se çmimet e bazuara në kontratat e muajve të fundit të 2008 dhe muajve të parë të 2009 nuk janë bazë e mirë krahasuese për çmimet mesatare të tërë vitit 2009. Prandaj, ZRrE nuk propozon të bëjë ndonjë ndryshim në çmimet e supozuara të importit.

- c) *Asetet e shpërndarjes përfshijnë një proporcion të madh të njehsorëve të cilët kanë nevojë për zëvendësim të shpeshtë. Prandaj, mesatarja e jetëgjatësisë së aseteve të shpërndarjes do të jetë më e vogël se ajo e aseteve të transmisionit dhe nuk është në rregull që të këto të barazohen në 35 vite. Jetëgjatësia e propozuar e aseteve të KEK-ut prej 30 vitesh është më e përshtatshme.*

ZRrE pajtohet më këtë propozim.

- d) *Jetëgjatësia prej 15 vitesh duhet të aplikohet për asetet e minierave. Asetet ekzistuese janë tashmë 20-30 vjeçare. Shpenzimet e planifikuara kapitale do të zgjatin jetëgjatësinë e tyre me rreth 15 vite. KEK do të financojë këto shpenzime përmes një huaje nga Qeveria e Kosovës, e cila do të ripaguhet për një periudhë mbi 15 vjeçare. Jetëgjatësia e përdorur për zhvlerësimin e këtyre aseteve duhet të përputhet me këtë periudhë huaje për të siguruar që KEK të fitojë mjaft të hyra për të përmbushur obligimet e borxheve të shërbimit të ndërlihdura më këtë hua.*

ZRrE vazhdon të konsiderojë që asetet ekzistuese pritet të mbesin në funksion për të shërbyer me kapacitet të ri gjenerues. ZRRE nuk propozon që të ndryshojë supozimin e saj në këtë aspekt.

- e) *KEK nuk po kërkon rritje në humbjet e shpërndarjes por një reduktim krahasuar me nivelet e realizuara të vitit 2008. KEK është duke arritur progres të qëndrueshëm në reduktimin e humbjeve.*

ZRrE konsideron se ka vendosur një cak sfidues por të arritshëm të humbjeve të distribucionit.

- f) *Nuk është roli i ZRRE-së që të përcaktojë numrin dhe koston e përshtatshme të punonjësve, por që vetëm të rishikojë arsyeshmërinë e shpenzimeve të përgjithshme të personelit. Rritja e kërkuar në numrin e stafit në zyrën qendrore përfaqëson punësimin e 54 punonjësve të rinj për auditim të brendshëm dhe për qëllime të mbrojtjes së të hyrave të cilat do të reduktojnë humbjet, 3 punonjës të rinj të IT-së dhe 3 punonjës të rinj të marrëdhënive me publikun për të përmirësuar komunikimet me palët e interesuara.*

ZRrE pajtohet që vendimet për plotësimin e stafit, rrogat dhe beneficinet i takojnë menaxhmentit të KEK-ut. Megjithatë, gjatë rishikimit të shpenzimeve të tërësishme të personelit, ZRRE pashmangshmërisht duhet të shqyrtojë arsyeshmërinë e niveleve të propozuara të plotësimit të stafit dhe të kostove të stafit.

ZRrE vëren se aplikacioni i KEK-ut propozon rritje totale të punonjësve prej 365 mbi nivelet e lejuara në vitin 2008. ZRRE e pranon, por jo në tërësi kërkesën e KEK-ut, duke lejuar 60 punonjës më shumë krahasuar me nivelin e lejuar të vitit 2008 me pritjen se kjo do të sjellë reduktime të mëtijshme të humbjeve dhe përmirësime të shkallës së inkasimit.

- g) *Rritja e kërkuar në shpenzimet operative të zyrës qendrore është për shkak të nevojës për të përmirësuar objektet e IT-së, duke përfshirë pjesëmarrjen në projektin CLRP të Bankës Botërore, kostot e rivendosjes së zyrave të KEK-ut si dhe themelimin e kompanisë së re të shpërndarjes dhe furnizimit.*

ZRrE i pranon këto kosto si të arsyeshme vetëm për këtë shqyrtim tarifor. Nga 2010 e tutje, ZRrE pret që shpenzimet operative të zyrës qendrore do të kthehen më afër niveleve të vitit 2008.

- h) *Të gjitha kompanitë e furnizimit me energji hyjnë në borxhe të këqija dhe në këtë mënyrë këto duhet të përfshihen në të hyrat e lejuara në njëfarë mase. Kostot afatshkurtra të financimit të kërkuara janë ekuivalente me kthimin në kapitalin e lejuar punues më parë të përfshirë nga ZRrE si pjesë e Bazës së Aseteve të Rregulluara (BAR).*

ZRrE propozon që të inkorporojë shumën e lejuar të kapitalit punues në RAB ashtu si është aplikuar më herët. ZRRE ka deklaruar edhe më herët se nuk konsideron që humbjet në inkasim, bashkë me borxhet e këqija, duhet të përfshihen në të hyrat e lejuara që mbulohen nga tarifat e rregulluara.

- i) *Propozimi i ZRrE-së për të rritur të gjitha tarifat në linjë më rritjen e propozuar në të hyrat e lejuara është e gabuar për dy arsye: (1) Supozon që shitjet e energjisë nuk do të rriten në vitin 2009, ndërsa KEK-u beson se ato do të rriten. Bilanci i miratuar i energjisë për vitin 2009 duhet të përdoret si bazë për përcaktimin e shitjeve të pritura. (2) Rritja e të gjitha tarifave me një përqindje të barabartë nuk i sjell tarifat më afër niveleve që reflektojnë koston. Kjo do të bënte të obligueshme rritje më të larta për konsumatorët tjerë ashtu si propozohet nga KEK-u.*

ZRrE kupton propozimin e KEK-ut se një rritje e konsiderueshme e shitjeve është e mundur në vitin 2009 (Bilanci Energjetik i vitit 2009 tregon shitje të nivelit të shpërndarjes prej 2,652 GWh krahasuar me 2,418 GWh të supozuar në vitin 2008 dhe shitjet e realizuara prej 2,230 GWh në vitin 2008). ZRrE vazhdon të besojë që këto nivele të rritjes janë të pasigurta në kushtet aktuale ekonomike dhe përfshirja e tyre në përcaktimin e të hyrave të lejuara do të vendoste rrezik të konsiderueshëm mbi të licencuarit që të hyrat e realizuara të jenë nën nivelet e lejuara, nëse shitjet aktuale janë nën nivelin e parashikuar. Për këtë arsye, ZRRE-ja nuk propozon të bëjë ndonjë ndryshim në këtë supozim.

ZRrE vëren se KEK-u ka propozuar një metodologji tjetër për llogaritjen e alokimit të kostos (dhe tarifave që reflektojnë koston) për kategoritë e konsumatorëve nga ajo që aplikohet nga ZRRE-ja. ZRrE-ja sheh të arsyeshme të aplikojë një rritje të përbashkët për të gjitha tarifat, përderisa është në procesin e vlerësimit të qasjes së KEK-ut.

3 Komentet e KOSTT-it

Komentet e KOSTT-it janë dorëzuar me shkrim më 13 mars 2009. Disa prej komenteve kanë pasur të bëjnë me terminologjinë dhe prezantimin e propozimeve të ZRrE-së. Komentet me ndikim në propozimin e ZRrE-së janë paraqitur më poshtë:

(a) Rritja e propozuar e humbjeve të transmisionit është rezultat i nevojës për shkyçje në disa faza në vitin 2009 për punët në programin e KOSTT-it të investimeve të planifikuara. Kërkohet ngritje e humbjeve të lejuara nga 199 në 211 GWh.

ZRrE pranon këtë koment vetëm për vitin 2009. ZRrE pret që pas përfundimit të investimeve, humbjet e transmisionit në vitin 2010 dhe në vitet që pasojnë do të reduktohen, krahasuar me humbjet që kemi pasur në vitet e mëparme.

(b) Nënshpenzimi në mirëmbajtje në vitin 2008 krahasuar me nivelet e lejuara ka qenë pasojë e faktorëve të ndryshëm duke përfshirë vonesat në prokurim dhe paqartësitë mbi të hyrat e lejuara në të ardhmen. Ky nënshpenzim pritet të sjellë një mbishpenzim në vitet që pasojnë.

ZRrE i lejon të licencuarit të mbajnë kostot e nënshpenzuara operative krahasuar me nivelet e lejuara. Për këtë arsye, KOSTT-i do të jetë në gjendje të përdorë diferencën në mes të shpenzimeve aktuale dhe të lejuara të mirëmbajtjes për të mbuluar mbishpenzimet eventuale në vitin 2009.

(c) KOSTT parasheh të punësorë 24 punëtorë shtesë në vitin 2009, duke përfshirë 17 operatorë të nënstacioneve, një auditor të brendshëm dhe gjashtë anëtarë të Bordit të Drejtorëve. Numri aktual i të punësuarve në vitin 2008 ka qenë 210, pra kjo do të paraqiste numër të përgjithshëm të stafit prej 234 në vitin 2009.

ZRrE pranon propozimin e nivelit të përgjithshëm të stafit prej 234, që pasqyron ngritje prej 4 punëtorësh mbi nivelin e propozuar në përcaktimin e të hyrave të lejuara të vitit 2008.

(d) KOSTT-i ka bërë një analizë të rrezikut me të cilin do të ballafaqohet në rast se prodhimi nga gjeneratorët dhe kërkesa është nën nivelet e pritura të ZRrE-së. Ky rrezik është i konsiderueshëm dhe duhet të mirret parasysh në përcaktimin e të hyrave të lejuara.

ZRrE thekson se ka qenë mjaftë i përmbajtur në propozimin mbi shitjet e energjisë elektrike, prandaj rreziku që shitjet aktuale do të jenë më të vogla krahasuar me propozimin e ZRrE-së është shumë i vogël.

4 Komentet e Ministrisë së Energjisë dhe Minierave

Komentet nga MEM janë marrë me shkrim më 13 mars 2008.

(a) Nuk duket e përshtatshme që të krahasohen kostot e importit në një treg kaotik si Kosova me ato në një treg të organizuar siç është EEX. Çmimet e importit mund të pritet që bien përderisa më shumë kapacitete të transmisionit vihen në dispozicion dhe ngarkesat e kyçjes reduktohen.

ZRrE pranon vështirësitë në krahasimin e kostove të importit në Kosovë me çmimet në shkëmbimet e organizuara evropiane të energjisë. Megjithatë, këto mund të ofrojnë një guidë të dobishme sa i përket niveleve aktuale të çmimit dhe trendeve të çmimit për të verifikuar arsyeshmërinë e kostove të importit të kërkuar nga të licencuarit. Supozimi i ZRrE-së rreth çmimeve të importit është që mesatarja në vitin 2009 do të jetë më e ulët se çmimi në kontratat e lidhura nga KEK-u në tre muajt e parë të vitit.

(b) Kosova A pritet të dalë nga funksioni në vitin 2017 dhe Kosova B jo të paktën deri në vitin 2027.

Për momentin, ZRrE-ja supozon jetëgjatësi prej 16 vitesh për të gjitha asetet e veprimtarisë së gjenerimit të KEK-ut. ZRrE-ja do të rishikojë nëse është e përshtatshme që të ndahen këto asete në ato që kanë të bëjnë me Kosovën A dhe Kosovën B dhe të aplikojë jetëgjatësi të ndara të aseteve në përputhje me datat e daljes së planifikuar nga funksioni para rishikimit të ardhshëm të tarifave.

(c) Humbjet teknike të lejuara të shpërndarjes duhet të jenë 17.1%, në përputhje me humbjet e realizuara të vitit 2008, dhe jo 17.4% si paraqitet në Raportin Konsultativ. Ky nivel humbesh tashmë është shumë i lartë dhe nuk i ofron KEK-ut stimuj për reduktimin e humbjeve.

ZRRE pajtohet se nuk është në rregull që të lejohet një rritje e humbjeve teknike të lejuara krahasuar me nivelet aktuale dhe propozon që në këtë mënyrë të reduktohen humbjet teknike të lejuara në 17.1%.

(d) Shpenzimet e lejuara të mirëmbajtjes për KOSTT rezultojnë të jenë tepër të larta, në veçanti duke pasur parasysh nivelin e realizuar në vitin 2008.

Referoju komentit të KOSTT (b) dhe përgjigjes së ZRrE-së. ZRrE-ja tashmë ka aplikuar një reduktim të konsiderueshëm në shpenzimet e mirëmbajtjes të kërkuar nga KOSTT.

(e) Çdo kursim i arritur në të hyrat e lejuara duhet të alokohet për mirëmbajtjen e Kosovës A dhe B duke pasur rëndësinë e tyre për sistemin.

ZRRE konsideron që kjo është çështje që i takon KEK-ut. Është përgjegjësi e KEK-ut që të kërkojë ndihmë financiare të përshtatshme për mirëmbajtje dhe të alokojë kursimet nga nënharxhimet e shpenzimeve të realizuara kundrejt atyre të lejuara në punët dhe fushat tjera.

(f) Tarifat për bllokun e parë të konsumatorëve shtëpiak (<200 kWh/muaj) nuk duhet të rriten duke pasur parasysh brengat në lidhje me përballeshmërinë.

ZRRE i ka parasysh këto brenga në lidhje me përballeshmërinë por gjithashtu e konsideron të nevojshme që të rriten tarifat për këtë bllok për të shmangur devijimin e mëtejshëm të tyre nga nivelet e tarifave që reflektojnë koston. Grupi i bllokut të parë të konsumimit të energjisë nën 200 kWh tashmë paguan një tarifë që është më e ulët se kostoja e prodhimit dhe e shërbimit të asaj energjie. Vitin e kaluar, rritja ishte dyfish më e lartë për bllokun 2 dhe 3 krahasuar me bllokun 1. Meqë tarifat e këtij blloku edhe ashtu janë të ulëta, rritja prej 2.5% do të reflektojë rritje më të ulët në vlerë nominale krahasuar me dy blloqet e tjera. Për këtë arsye dhe me qëllim të përafritimit të një tarife që reflekton koston e prodhimit, ZRrE-ja vazhdon të mbështesë propozimin e dhënë në Raportin Konsultativ.

5 Komentet e FOL '08

(a) Nuk duhet të lejohet rritja e tarifave duke pasur parasysh vështirësitë ekonomike më të cilat përballen qytetarët kosovarë.

ZRrE-ja e mirëpret iniciativën e shoqërisë civile për të marrë mendimet e qytetarëve lidhur me ngritjen eventuale të tarifës së energjisë elektrike. Në takimin e mbajtur më 13 shkurt 2009 me përfaqësuesit e shoqërisë civile, ZRrE-ja kishte sqaruar se është e njohur mirë me vështirësitë ekonomike më të cilën përballohen 365,000 konsumatorët e kyçur në KEK, dhe se ngritja prej 2.5%

është vlera më e ulët me të cilën mund të funksionojë normalisht KEK-u. ZRrE konsideron se nuk cenohet përballueshmëria kur mirret parasysh fakti se ngritja prej 2.5% reflekton rritje të faturës mesatare prej vetëm 0.60 euro.

6 Konkluzionet

Pas rishikimit të komenteve të pranuar, ZRrE-ja propozon që të bëjë disa rregullime në propozimet për të hyrat e lejuara të dhëna në Raportin Konsultativ. Gjithsejtë, këto rregullime do të rritnin të hyrat e lejuara me përafërsisht 1.83 milion euro për KEK-un dhe 40,000 euro për KOSTT-in.

Megjithatë, këto rritje neutralizohen nga reduktimi i propozuar në humbjet teknike të lejuara të shpërndarjes nga 17.4% në 17.1%. Kjo do të reduktojë importet e energjisë me rreth 18 GWh në vitin 2009. Me koston e supozuar të importit nga ZRrE prej €112.5/MWh, ky reduktim në import paraqet zvogëlim kostoje prej €2 milion euro. Prandaj, ndryshimi neto në të hyrat e përgjithshme të lejuara që mbulohen nga tarifat e rregulluara është përafërsisht zero.

Si rezultat, ZRRE-ja vazhdon të mbështesë propozimin e dhënë në Raportin Konsultativ, që paraqet rritje të tarifave me pakicë të energjisë elektrike prej 2.5%.